

## Çfarë duhet të dijnë prindërit dhe kujdestarët rreth platformës

# AMINO

Amino është një platformë e rrjeteve sociale që ofron një grup të madh nënkomunitetesh nën një 'çati' dixhitale; ishte parashikuar si versioni online i një konvente, ku fansat mbledhen për të festuar një interes të përbashkët për shembull, për librat komikë ose fantastiko-shkencor. Derisa shumë platforma të tilla janë hapësira të padëmshme për t'u mbledhur për adhuruesit e një shfaqjeje të caktuar televizive ose video-loje, ka ende disa aspekte që të rriturit e besueshëm duhet të jenë të vetëdijshëm. Me fokus në ndarjen e përmbajtjes së krijuar nga përdoruesit, ideja e platformës Amino është që përdoruesit të komunikojnë me individë me të njëjtin mendim - por edhe kjo mund të krijojë shumë rreziqe.



Cilat janë rreziqet?

### BASHKËSITË E MODERIMIT


Amino ka një klasifikim moshe 12+ në App Store dhe një vlerësim 'Për adoleshent' në Google Play. Megjithatë, disa komunitete në platformë kanë pak ose aspak kontrollë - duke rritur kështu potencialin për më shumë përmbajtje për të rritur, për t'i kapur përdoruesit e rinj. Gjithashtu është e mundur të krijosh një llogari pa dëshmi të moshës, duke rritur mundësinë që fëmijët edhe më të vegjël në moshë, të gjejnë rrugën e tyre në platformë.

### PËRMBAJTJE E PASIGURT

Koncepti qendror pas Amino-s si aplikacion është që përdoruesit të shpërndajnë përmbajtjen, më pas të bëjnë dhe të marrin komente për këto ngarkime. Niveli i anonimitetit që ofron platforma (për shembull: identiteti i vërtetë i dikujt mund të jetë plotësisht i errësuar/fshehur pas emrit të tyre të përdoruesit) do të thotë se është jashtëzakonisht e vështirë të ndalosh dërgimin e komenteve dhe mesazheve sugjестive ose grabitqare për të rinjtë.

### PËRDORIM I PËRSËRITUR

Si një aplikacion i rrjeteve sociale, Amino është i përqendruar në mbajtjen e komuniteteve të tij të angazhuara dhe të kërkojë vazhdimisht më shumë të tillë. Një pjesë e kësaj qasjeje është inkurajimi i njerëzve që të krijojnë 'vija', pasi përdoruesve u jepen 'pikë reputacioni' për regjistrimin e rregullt. Ky lloj mekanizmi, natyrisht, mbart gjithmonë rrezikun që të rinjtë të ndajnë një detyrim për të kontrolluar vazhdimisht aplikacionin, duke rritur më tej kohën e tyre para ekranit.



### IMAZHE TË PAPËRSHTATSHME (I CENZURUAR)

Si shumica e rrjeteve sociale, edhe Amino ofron shpërndarje të lehtë të imazheve. Udhëzimet e tij në komunitet thonë se çdo foto sugjeruese nën 18-vjeç do të hiqet menjëherë, por sigurisht kjo nuk parandalon që fotografitë e papërshtatshme të shihen nga një i ri. Jo të gjitha komunitetet e Amino-s janë të kontrolluara në mënyrë rigoroze, kështu që ka një shans që disa imazhe të papërshtatshme të shmangin përkohësisht zbulimin.

### SHPENZIMET E ANËTARËSISË

Amino+ është një anëtarësim premium për platformën, duke ofruar një sërë zgjedhjesh personalizimi si ngjitësa, 'moods' për t'u shfaqur dhe një shenjë dalluese ekskluzive të profilit. Përdoruesit mund të blejnë gjithashtu artikuj kozmetikë one-off (që shiten vetëm njëherë, pa përsëritje), duke përfshirë stile të ndryshme të flluskave të bisedës ose kornizave të profilit. Nëse fëmija juaj ka mënyra pagese të disponueshme nëpërmjet pajisjes së tij, ai mund t'i kryejë këto blerje përmes aplikacionit pa e ditur ju.

## KËSHILLË PËR PRINDËRIT & KUJDESTARËT

### FLISNI PËRRETH SAJ

Nëse fëmija juaj është mjaft i rritur dhe zgjedh të shkarkojë dhe përdorë platformën Amino, ndoshta është e udhës t'ua përkujtoni atyre disa nga baza të sigurisë në internet, - si për shembull, në botën dixhitale jo të gjithë janë ata që pretendojnë se janë, dhe të mos japim informacion personale internet. Mund të jetë gjithashtu një ide e mirë të shkoni te cilësimet e aplikacionit dhe të çaktivizoni kërkesat hyrëse të bisedës nga përdoruesit që fëmija juaj nuk i njeh.

### TË MENDUARIT RRETH ANTARËSIMIT

Nëse fëmija juaj kërkon një anëtarësim në Amino+, por ju nuk jeni plotësisht të kënaqur me këtë, jini të përgatitur për të shpjeguar vendimin tuaj thellësisht. Ndjenja e padrejtësisë tek të rinjtë mund të ndizet natyrisht kur miqtë e tyre kanë gjëra që ata nuk i kanë. Ndërkohë, prindërit e adoleshentëve më të rritur mund të vendosin të pranojnë kërkesën për anëtarësim, por të vazhdojnë të kontrollojnë aktivitetin e fëmijës së tyre në aplikacion.

### QËNDRONI TË PËRDITËSUAR

Sigurohuni që fëmija juaj të dijë t'ju raportojë çdo përmbajtje shqetësuese dhe të bezdisshme që mund ta shohë në internet. Sa më shumë që të jetë e mundur, përipiquni të qëndroni të vetëdijshëm se me cilat komunitete po bashkohen në Amino. Shumica e këtyre zonave janë të kontrolluara mirë dhe plot me biseda naive rreth interesave të përbashkëta, por në çdo platformë të kësaj gjerësie, ka gjithmonë mundësi që bisedat të kalojnë në vende potencialisht të dëmshme.

### VËZHGONI KOHËN PARA EKRANIT

Nëse nuk e keni bërë tashmë, mund të merrni në konsideratë konfigurimin e kontrolleve të tilla si Family Sharing (në pajisjet iOS) ose Family Link (në Android), në mënyrë që nga pajisja juaj të mund të mbani një sy se sa kohë kalon para ekranit fëmija juaj dhe në cilat aplikacione. Kjo mund të jetë jashtëzakonisht e dobishme në lidhje me platforma të tilla si Amino, të cilat mund të jenë mjaft të varura dhe të shpërblejnë përdorimin e përsëritur.

**PENKOS**  
Parents Education Network of Kosova



Përkthim dhe përshtatje  
Source: <https://www.dailyrecord.co.uk/news/scottish-news/mum-horrified-after-daughter-10-18773339>